

DEKRET
Nr. 11313, datë 15.10.2019

PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të nenit 93, 125, pikat 1 dhe 3, 129, 179, pikat 2 dhe 12, të Kushtetutës së Shqipërisë, neneve 7, 7/a, pika 4, 7/b, 8 dhe 86, pika 4, germa “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi administrova në datën 8.10.2019 “Listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve të lejuar për kandidim dhe raportin e arsyetuar të renditjes së tyre, për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese (vakancë e plotë) e shpallur, nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 10722, datë 7.2.2018”, akte këto të miratuara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me vendimin nr. 128, datë 21.9.2019 dhe vendimin nr. 129, datë 21.9.2019, si dhe pasi u njoha me përmbajtjen e praktikës dokumentare të vendimmarrjes dhe vlerësimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për kandidatët e ngelur në garë për plotësimin e kësaj vakance dhe të renditur në tri vendet e para të listës, përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresë nr. 552 prot., datë 8.10.2019, në përfundim vendosa të,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Besnik Muçi emërohet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta